REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23 regjistër (JR)
Datë 26.06.2020

Nr. 39 i vendimit
Datë 21.12.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	**Kryesuese**
Rezarta Schuetz	**Relatore**
Albana Shtylla	**Anëtare**
Ardian Hajdari	**Anëtar**
Natasha Mulaj	**Anëtare**

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 21.12.2020, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Elona Kana, këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 233, datë 03.02.2020.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; dhe nenet 62, 63, 64, 65 e 66 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi shkaqet dhe

pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana (në vijim "subjekti i rivlerësimit"), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë. Bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio.* Çështja u shortua në Komision në datën 15.05.2018.

2. Në datat 07.05.2018 – 08.05.2018, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua testimit për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio,* të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës. Pas kalimit me sukses të testimit, subjekti i rivlerësimit zgjodhi të ndjekë programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në profilin "gjyqtar".

3. Më datë 17.05.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni") vendosi fillimin e hetimit administrativ mbi procedurën e rivlerësimit. Më datë 10.07.2019, Komisioni vendosi përfundimin e hetimit administrativ për të tria kriteret e vlerësimit dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e barrës së provës mbi rezultatet e këtij procesi. Më datë 25.09.2019, Komisioni vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore që do të zhvillohej më datë 02.10.2019. Pas rrëzimit të kërkesës së parashtruar në fillim të seancës dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit për përjashtimin e relatores së çështjes[1], Komisioni vendosi të vijojë seancën më datë 10.10.2019.

4. Më datë 04.10.2019, subjekti i rivlerësimit i paraqiti Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës [për dijeni Komisionit të Pavarur të Kualifikimit] dorëheqjen me shkrim nga vazhdimi i mëtejshëm i procesit akademik/praktik pranë Shkollës së Magjistraturës, duke shprehur vendimin e saj të pakthyeshëm për të ndërprerë periudhën e stazhit dhe marrëdhënien me Shkollën e Magjistraturës.

5. Më datë 10.10.2019, Komisioni vendosi riçeljen e hetimit administrativ për verifikimin e dorëheqjes[2] dhe, më datë 27.01.2020, vendosi të përfundojë hetimin dhe të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Kana, në seancë dëgjimore më datë 30.01.2020, për t'i dhënë mundësinë për t'u dëgjuar lidhur me kërkesën e dorëheqjes, si një ndër elementet e procesit të rregullt ligjor në shqyrtimin e çështjes, që sjell pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin ligjor të saj. Më datë 28.01.2020, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin mbi pamundësinë objektive për të marrë pjesë në seancë dëgjimore deri më datë 02.02.2020. Në vijim, Komisioni vendosi zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 03.02.2020. Meqenëse subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, zgjodhi të mos ishte e pranishme, seanca dëgjimore e datës 03.02.2020 u zhvillua në mungesë të saj. Në përfundim të seancës, Komisioni vendosi të ndërpresë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit.

---

[1] *Vendimi i datës 04.10.2019.*
[2] *Regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 09.10.2019.*

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Me vendimin nr. 233, datë 03.02.2020, Komisioni vendosi të deklarojë të ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit dhe, në zbatim të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar në pozicione të caktuara për një periudhë 15-vjeçare[3].

III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim kundër vendimit të Komisionit [nr. 233, datë 03.02.2020] që vendosi sa më sipër, duke kërkuar ndryshimin/prishjen e tij dhe deklarimin të përfunduar të procesit të rivlerësimit kalimtar, pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur[4]. Ankimi i subjektit të rivlerësimit mbështetet në nenin 42 të Kushtetutës, në nenin F të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNj"), në nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe në nenet 62, 63, 64, 65 e 66 të ligjit nr. 84/2016.

7. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i paligjshëm dhe i paarsyetuar, vjen në kundërshtim me parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga KEDNj-ja. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit lidhen me:

7.1. *interpretimin e gabuar për zbatimin e pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, pasi në rastin e saj Komisioni gjendej përpara një omisioni ligjor, duke qenë se në momentin e dorëheqjes ajo ka qenë studente e Shkollës së Magjistraturës, e kishte humbur cilësinë e të qenit subjekt rivlerësimi me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës si ndihmëse/këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë, për shkak të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";*

7.2. *mënyrën e funksionimit të Komisionit, i cili nuk gëzon elementet e nevojshme për garantimin e gjykimit të drejtë dhe respektimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së dhe, për pasojë, nuk mund të konsiderohet gjykatë;*

7.3. *masën ndaluese prej 15 vitesh, të dhënë për subjektin, e cila cenon parimin e proporcionalitetit në raport me specifikat e rastit, cenon të drejtën për punë dhe të drejtën për një jetë të qetë private në kuptim të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNj-së.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

8. Ankimi i subjektit të rivlerësimit u mor në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi në bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016[5]. Më datë 02.12.2020, subjekti i rivlerësimit konfirmoi marrjen e njoftimit (19 ditë përpara zhvillimit të

---

[3] *Neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: "[2]. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare […]".*

[4] *Ankimi mban datën 24.03.2020 dhe është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.03.2020. Sipas procesverbalit të Komisionit të datës 30.03.2020, ankimi është depozituar në postë më datë 24.04.2020 dhe ka mbërritur fizikisht (nëpërmjet postës) në Komision më datë 25.03.2020. Me vendimin e datës 30.03.2020, Komisioni vendosi pranimin e ankimit. Subjekti i rivlerësimit konfirmoi marrjen e vendimit për pranimin e ankimit, në rrugë elektronike, më datë 31.03.2020.*

[5] *http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Shpallja-SR-Elona-Kana.pdf.*

seancës). Përgjatë periudhës nga data e konfirmimit të marrjes së njoftimit (datë 02.12.2020) deri 5 ditë përpara zhvillimit të seancës së shqyrtimit të çështjes (datë 16.12.2020), subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti parashtrime me shkrim mbi shkaqet e ngritura në ankim, sikurse parashikon neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 49/2012"). Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "trupi gjykues i Kolegjit"), konstatoi se nuk gjendet para asnjë prej situatave të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 dhe, në zbatim të nenit 49 të po këtij ligji, vendosi të vazhdojë gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi.

B. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit.

9. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, pretendon se Komisioni gjendej përpara një *omisioni* ligjor dhe duhej të zbatonte nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative pasi ishte në pamundësi për të dhënë vendim përfundimtar, meqenëse në momentin e dhënies së dorëheqjes, ajo ka qenë studente e Shkollës së Magjistraturës dhe nuk gëzonte asnjë status tjetër në kuptim të legjislacionit. Sipas subjektit, ometimi ligjor i situatës së saj dëshmohet nga krahasimi me subjektet e tjera, ndër të cilat edhe znj. V.P. (B.) që, ndonëse të ngjashme, bazohen në rrethana faktike të ndryshme. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk ka dhënë dorëheqjen nga detyra e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, por është larguar nga kjo detyrë në zbatim të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 96/2016"). Në rastin e saj, ometimi ligjor është i qartë, pasi as Kushtetuta dhe as legjislacioni nuk ka parashikuar se çfarë vendimi do të duhet të marrin institucionet e rivlerësimit për ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, apo për subjekte të tjera që vazhdojnë Shkollën e Magjistraturës dhe dorëhiqen nga detyra për shkak të së cilës u bënë subjekte rivlerësimit. Në rast se subjekti e kalon procesin e rivlerësimit por dorëhiqet nga vazhdimi i studimeve në Shkollën e Magjistraturës, kthimi në detyrën e mëparshme në Gjykatën e Lartë është i pamundur pasi ajo ka dhënë dorëheqjen.

10. Komisioni nuk duhet të interpretojë legjislacionin në mënyrë të zgjeruar dhe "paradoksale", pasi procesi i rivlerësimit për subjektet lidhet me qëndrimin në detyrën përkatëse publike. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, ajo ka dhënë dorëheqjen nga një e drejtë si studente në Shkollën e Magjistraturës dhe jo nga një detyrë që do të passillte zbatimin e nenit G të Kushtetutës. Interpretimi se kushdo që jep dorëheqjen bie automatikisht nën rregullimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është një interpretim i "verbër" dhe përbën argument në favor të tezës së subjektit se në rastin e saj, institucionet gjenden përpara një ometimi ligjor. Rrethanat e faktit në rastin e saj nuk lejojnë aplikimin e pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës; për pasojë aplikimi i tij do të përbënte një ndalim/penalitet pa ligj. Sipas subjektit të rivlerësimit, legjislatori ka dështuar të parashikojë e të rregullojë situatën e subjektit dhe Komisioni nuk ka kompetencë të plotësojë përmes interpretimit të zgjeruar një normë kushtetuese me karakter penalizues. Subjekti e mbështet argumentin në qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 20/2006 dhe në *Delcourt kundër Belgjikës, datë 17.01.1970, të GjEDNj-së.*

11. Në lidhje me fazën që ka përbërë pjesën fundore të procesit të zhvilluar, në vijim të dorëheqjes së subjektit, nga analiza e akteve në fashikuj, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka verifikuar shprehjen e vullnetit të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqjen e dhënë, nisur nga pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, bazuar në orientimin e dhënë nga

Kolegji. Komisioni së pari konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, vijoi të gëzojë statusin e këshilltares ligjore edhe gjatë trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në zbatim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës. Ndjekja e programit dyvjeçar të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës ka qenë për shkak të statusit *ex officio* si këshilltare ligjore, që subjekti i rivlerësimit gëzonte. Përveç verifikimit të vullnetit të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqjen e dhënë në Shkollën e Magjistraturës dhe hapat e ndërmarrë nga ky institucion, Komisioni i dha mundësinë subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, të shprehet mbi dorëheqjen dhe pasojat mbi statusin e saj ligjor, sipas përcaktimit në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016. Në përfundim, Komisioni arsyetoi se dorëheqja nga praktika/stazhi në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës, për sa kohë që procesi i rivlerësimit për të nuk kishte përfunduar ende, konsiderohet si tërheqje nga statusi i këshilltares ligjore, tërheqje nga detyra dhe heqje dorë nga procesi i rivlerësimit. Sipas Komisionit, në kushtet kur dorëheqja është dhënë përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit, kjo passjell mungesën e kompetencës së Komisionit për të vijuar procesin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, ndërprerjen e këtij procesi, si pasojë e ekzistencës së shkakut ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin G të Aneksit të Kushtetutës (dorëheqja nga detyra e subjektit të rivlerësimit). Komisioni shprehet se kjo zgjedhje përputhet me objektivin e kryerjes së procesit të rivlerësimit dhe me vendimet e mëparshme të marra në raste të njëjta apo të ngjashme të dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit nga detyra gjatë këtij procesi.

12. Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës së Lartë[6] që prej datës 31.10.2012. Në vitin 2018, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua testimit të aftësive profesionale [07.05.2018 dhe 08.05.2018], në kuadër të procedurës së zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës për subjektet *ex officio të cilët nuk ishin magjistratë*, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, nenit 266 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe në rregulloren e brendshme të Shkollës së Magjistraturës. Pas rezultateve të testimit për 47 subjekte të rivlerësimit *ex officio jomagjistratë,* ndër të cilët edhe subjekti i rivlerësimit[7], në datën 24.09.2018, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka vendosur fillimin e vitit të parë akademik më datë 01.10.2019 për 10 subjektet e rivlerësimit *ex officio* të cilët kanë arritur të paktën 60% të pikëve të testit të aftësive profesionale. Vendimi specifikon më tej se subjektet e rivlerësimit që do të ndjekin këtë program do të përfitojnë pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit. Më datë 25.09.2018, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, në cilësinë e titullarit të institucionit, të disponojë lidhur me marrëdhënien e saj të punës në këtë institucion, duke qenë se ndërkohë ka fituar të drejtën të ndjekë Shkollën e Magjistraturës dhe të fitojë statusin e magjistratit. Po atë ditë, më datë 25.09.2018, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka urdhëruar përfundimin e marrëdhënieve të punësimit për subjektin e rivlerësimit dhe përfundimin e marrëdhënieve financiare duke filluar nga data 01.10.2018, duke iu referuar studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës. Më datë 25.09.2018, subjekti i rivlerësimit plotësoi deklaratën sipas

[6] *Më datë 31.10.2012, subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, është emëruar ndihmëse ligjore pranë gjyqtares së Gjykatës së Lartë M. A. dhe më 16.09.2016 është emëruar pranë gjyqtarit A. Z., me afat të caktuar deri në përfundimin e mandatit të këtij gjyqtari.*

[7] *Vendimi nr. {***}, datë 21.05.2018, i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 23.05.2018.*

së cilës përzgjodhi të ndjekë programin e formimit profesional në Shkollën e Magjistraturës, për profilin "gjyqtar".

13. Paralelisht me veprimet e kryera për ndjekjen e Programit të Formimit Profesional, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar plotësisht procedurës së rivlerësimit. Konkretisht, në datat 26.01.2017 dhe 27.01.2017, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar formularët e vetëdeklarimit për verifikimin e pasurisë, për kontrollin e figurës dhe për vlerësimin e aftësive profesionale. Përgjatë periudhës 27.06.2018[8] – 02.10.2019 [16 muaj], subjekti i rivlerësimit ka mbajtur komunikime të vazhdueshme me Komisionin, ka dhënë përgjigje dhe ka dërguar akte dhe dokumente për të provuar dhe vërtetuar deklarimet e kryera, ka marrë njoftime dhe ka depozituar kërkesa, si dhe ka marrë pjesë në seancën e parë dëgjimore të zhvilluar më datë 02.10.2019. Komisioni kreu hetimin administrativ, pasi administroi raportet e të tria institucioneve (Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave[9], Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar[10] dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë[11]). Në përfundim të hetimit administrativ, më datë 15.07.2019, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjet e konstatuara, kryesisht në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, nuk u konstatuan probleme. Më datë 16.07.2019, subjekti i rivlerësimit plotësoi deklaratën për njohjen dhe marrjen e dokumentacionit të administruar nga Komisioni lidhur me hetimin administrativ. Pasi subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ (më datë 29.08.2019), Komisioni e ftoi në seancë dëgjimore, në fillim të së cilës subjekti i rivlerësimit parashtroi kërkesën për përjashtimin e relatores së çështjes. Pas rrëzimit të kërkesës nga një tjetër trup gjykues i Komisionit, subjekti i rivlerësimit u ftua për të vijuar seancën dëgjimore.

14. Në vijim të vënies në dijeni (më datë 09.10.2019) për dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit nga vazhdimi i mëtejshëm i procesit akademik/praktik pranë Shkollës së Magjistraturës, Komisioni ndërmori veprime të tjera hetimore administrative përgjatë periudhës tetor 2019 – janar 2020, që përfshinin kryesisht korrespondencë shkresore me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor (përfshirë edhe magjistratët udhëheqës të caktuar nga Këshilli për të kryer vlerësimin etik dhe profesional për vitin e dytë të programit të trajnimit).

15. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës ka informuar Komisionin se më datë 14.10.2019, pas dorëzimit të kërkesës për dorëheqje[12] – është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve financiare ndërmjet Shkollës së Magjistraturës dhe znj. Kana. Në shkresë specifikohet edhe që në rastet e dorëheqjeve nga programi i formimit fillestar, kandidatët për magjistratë çregjistrohen dhe humbasin statusin e kandidatit për magjistrat, me efekt të menjëhershëm, pa iu nënshtruar

---

[8] Përcjellë njoftimi në rrugë elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit për subjektin, përbërjen e trupit gjykues të Komisionit, të drejtën për deklarimin e konfliktit të interesit, si dhe dërgimin e pyetësorit standard. Konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit më datë 28.06.2018.

*[9] Dërguar raporti me shkresën nr. {***} prot., datë 27.03.2018, regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 04.05.2018.*

*[10] Dërguar raporti i grupit të punës me shkresën nr. {***} prot., datë 23.07.2018, regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 25.07.2018.*

*[11] Dërguar raporti me shkresën nr. {***} prot., datë 02.10.2018, regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 03.10.2018.*

*[12] Regjistruar pranë Shkollës së Magjistraturës me nr. {***} prot., datë 04.10.2019.*

miratimit nga këshilli drejtues i Shkollës së Magjistraturës apo nga këshillat përkatës, siç do të ishte rasti për magjistratët sipas nenit 65 të ligjit nr. 96/2016. Këshilli i Lartë Gjyqësor po në formë shkresore[13] ka sqaruar, duke qenë se marrëdhënia e punës e znj. Kana me Gjykatën e Lartë është ndërprerë me vendim të organit i publik [Gjykata e Lartë], çështja është e përfunduar dhe Këshilli nuk ka detyrim apo tagër të shprehet më tej. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor shprehet se për ndërprerjen e programit të trajnimit dyvjeçar nga znj. Kana, për shkak të dorëheqjes së saj, është shprehur Shkolla e Magjistraturës, organi publik që, në zbatim të nenit 244 të ligjit nr. 115/2016, është ngarkuar me funksionin e sigurimit të formimit profesional të magjistratëve. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin e datës 28.01.2020, vendosi që kandidatët për magjistratë, subjekte rivlerësimi *ex officio,* të cilët shkarkohen me vendim të formës së prerë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit ose paraqesin kërkesën për dorëheqje, nuk detyrohen të kthejnë pagat e përfituara gjatë programit të trajnimit dyvjeçar.

16. Në analizë të sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje së pari se ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë përfshihen në kategorinë e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, në vijim të parashikimeve të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe neneve 3, pika 16[14] dhe 42, pika 2[15] e ligjit nr. 84/2016. Ky përcaktim është i pavarur dhe i pakushtëzuar nga vullneti i kësaj kategorie subjektesh për të ndjekur studime të ciklit të përshpejtuar në Shkollën e Magjistraturës, apo *nga* rezultatet e testimit të aftësive të tyre profesionale të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës. Me fjalë të tjera, në mënyrë të shprehur, ligjvënësi i ka kategorizuar ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë si subjekte të rivlerësimit.

17. Së pari, nga 10 (dhjetë) subjektet e rivlerësimit *ex officio* të kualifikuar për të ndjekur programin e formimit profesional dyvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës[16], procesi i rivlerësimit ka përfunduar nga Komisioni për 9 (nëntë) prej tyre[17], ndërkohë që mbetej përfundimi i procesit të rivlerësimit për znj. Kana. Së dyti, referuar parashikimeve të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, mundësia për të ndjekur programin e trajnimit dyvjeçar në Shkollën e Magjistraturës, për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, ndër të cilat edhe znj. Kana, përbënte një lehtësi ligjore. Mundësia për të qenë kandidatë për magjistratë, sipas këtyre dispozitave, iu ofrua vetëm subjekteve *ex officio* që nuk gëzonin statusin e magjistratit. Më konkretisht, këto lehtësi ligjore parashikonin që:

a) ndryshe nga procedura e zakonshme e rekrutimit që ndjek Shkolla e Magjistraturës për studentët që vijnë nga jashtë sistemit, procedura që do të ndiqej për subjektet e rivlerësimit *ex officio* jomagjistratë [këshilltarët ligjorë/ndihmësit ligjorë/inspektorë], sipas nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, ndryshon nga procedura e zakonshme e rekrutimit, parashikuar nga nenet 28-34 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë kontekst, programi i trajnimit profesional që ndiqet nga Shkolla e Magjistraturës në rastin e rekrutimit të subjekteve të rivlerësimit *ex officio* të

---

*[13] Shkresa nr. {***} prot., datë 21.01.2020.*

[14] "[…] 16. "Subjekt i rivlerësimit" janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës. […]"

[15] "[…] 2. Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në:
a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe
b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës."

*[16] Vendimi nr. {***}, datë 24.09.2018, i këshillit drejtues të Shkollës së Magjistraturës.*

[17] Ndër ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, si rrjedhojë e procesit të rivlerësimit të zhvilluar nga Komisioni, 4 (katër) prej tyre u konfirmuan me vendim të formës së prerë.

parashikuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës është specifik dhe zgjat vetëm 2 vite, përkundër 3 (tri) viteve që është cikli i rregullt;

b) subjektet e rivlerësimit *ex officio,* sipas përcaktimeve të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nuk përfitojnë bursë sikurse ndodh në rekrutimet e zakonshme, por përfitojnë pagë të barabartë me pagën e pozicionit të tyre respektiv, që në rastin konkret është e njëjtë me pagën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Ky përfitim nuk kthehet mbrapsht nëse kandidati për magjistrat nuk e vazhdon më tej Shkollën e Magjistraturës, në ndryshim nga parashikimet e nenit 19 të ligjit nr. 96/2016[18] (procedurë e konfirmuar edhe me vendimin nr. 8/2020 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës).

18. Ligji nr. 96/2016, në nenin 165 nuk parashikon humbjen e cilësisë së subjektit të rivlerësimit *ex officio* për shkak të ndjekjes së programit të formimit profesional në Shkollën e Magjistraturës, përkundrazi. Gjuha dhe fryma e dispozitave që rregullojnë procesin e rivlerësimit, dhe sidomos neni 165, pika 8 e ligjit nr. 96/2016, përcaktojnë që *moskalimi* me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për ndërprerjen e programit akademik në Shkollën e Magjistraturës[19]. Dorëheqja e subjektit të rivlerësimit nga vazhdimi i programit akademik në Shkollën e Magjistraturës, në rastin hipotetik kur procesi i rivlerësimit për të do të kishte përfunduar me sukses për të tria kriteret, do të kishte efekt vetëm duke passjellë pamundësinë e fitimit të statusit të magjistrates [në profilin "gjyqtare"], por nuk do të përbënte asnjë pengesë për t'u zgjedhur në pozicione të tjera të sistemit të drejtësisë.

19. Trupi gjykues vëren se përkundër çfarë pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, në ankim mbi ekzistencën e një "ometimi ligjor për të dhënë masën e ndalimit", ajo gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka paraqitur në asnjë moment kërkesë ku të parashtrojë pretendimin se nuk duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit pasi nuk përfshihej më në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, duke qenë se tashmë ishte studente pranë Shkollës së Magjistraturës apo për shkak se marrëdhënia e punës si ndihmëse ligjore, për të cilën kishte fituar statusin e subjektit të rivlerësimit, kishte përfunduar në shtator 2018.

20. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit thekson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, ka vijuar të ndjekë programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pikërisht për shkak të statusit ligjor të veçantë që ajo ka pasur në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të parashikimeve ligjore që normonin procesin e rivlerësimit dhe statusin e magjistratëve, sikurse u trajtua edhe në paragrafin 17 të këtij vendimi. Vetë pritshmëritë e subjektit të

---

[18] Neni 19 parashikon: "[…] 4. Kandidati për magjistrat është i detyruar të kthejë shumën e përfituar të bursës së shkollimit, brenda një viti, në rastet kur: a) kandidati është përjashtuar ose ka lënë shkollën; b) në rastet kur kandidati për magjistrat nuk kandidon për t'u emëruar në një pozicion brenda një viti nga përfundimi i formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës. 5. Kandidati magjistrat duhet të kthejë 50 për qind të shumës së përfituar të bursës së shkollimit që është marrë gjatë tri viteve të kursit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në rastet kur: a) kandidati për magjistrat nuk plotëson kushtet e emërimit si magjistrat, sipas nenit 40 të këtij ligji; b) mandati i magjistratit ka përfunduar përpara plotësimit të paktën të pesë viteve të ushtrimit të funksionit […]".

[19] Neni 165 parashikon: "[8] Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në kuptim të këtij neni, nuk kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, marrëdhënia e punës së tyre mbaron në datën e fillimit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në zbatim të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH". I njëjti rregull zbatohet edhe për ata, të cilët nuk kanë përfunduar ende procesin e rivlerësimit, por kanë kaluar me sukses testimin e aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, në kuptim të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve". Në rast se institucioni për rivlerësimin merr vendim për masën e shkarkimit, ndërpritet ndjekja e programit të trajnimit dhe subjekti përjashtohet nga programi i trajnimit".

rivlerësimit për të fituar statusin "magjistrat – profili gjyqtar" ishin të qarta në kushtet kur kishte kaluar me sukses procesin e testimit të aftësive profesionale të zhvilluar në maj 2018 nga Shkolla e Magjistraturës dhe po vijonte frekuentimin e saj, duke përfunduar vitin e parë të programit, me vlerësimin në nivelin "shumë mirë", për vitin akademik 2018 – 2019, në profilin e gjyqtares. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit thekson se të gjitha subjektet e parashikuara në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës – si edhe subjekti i rivlerësimit – janë bërë subjekte të rivlerësimit *ex officio në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese.* Ky status humbet vetëm në rast se procesi i rivlerësimit pushon apo ndërpritet, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe jo për shkak të ndjekjes së Programit të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

21. Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se akti i dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit para vitit të dytë të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka ndodhur në një fazë të rëndësishme të procesit të rivlerësimit – pas ndërprerjes së seancës dëgjimore – fazë kjo që i paraprin marrjes së vendimit nga ana e Komisionit. Me veprime konkludente, subjekti i rivlerësimit ka dëshiruar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Legjislacioni që normon procesin e rivlerësimit parashikon qartësisht se institucionet e rivlerësimit duhet të rivlerësojnë subjektet e përcaktuara shprehimisht në pikat 3 dhe 4 të nenit 179/b të Kushtetutës. Në rast se këto subjekte vendosin të mos i nënshtrohen këtij procesi, atëherë ata përjashtohen nga mundësia e emërimit në disa prej organeve të drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare, sipas përcaktimeve në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Nga aktet në fashikuj, rezulton se pasi Komisioni administroi dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit nga ndjekja e procesit mësimor pranë Shkollës së Magjistraturës, vijoi procesin duke riçelur hetimin administrativ për verifikimin e kësaj situate mbi statusin ligjor të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, vërehet se dorëheqja është konfirmuar dhe është vijuar me tej me aplikimin e pasojave nga Shkolla e Magjistraturës, si institucioni që kujdesej për procesin e trajnimit profesional të subjektit të rivlerësimit. Subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, iu dha mundësia të shprehej mbi dorëheqjen dhe pasojat e mundshme mbi statusin ligjor të saj në kontekstin e rivlerësimit. Në përfundim, pasi vlerësoi në tërësi situatën në lidhje me statusin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, Komisioni i dha mundësinë asaj të dëgjohej në seancë dëgjimore edhe sa u përket pasojave të disponimit që u bë pjesë e dispozitivit, që përfshinte ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Referuar këtyre rrethanave, vlerësohet se Komisioni e ka ezauruar orientimin e Kolegjit për verifikimin e vullnetit të pavesuar për dorëheqje të subjektit të rivlerësimit[20]. Parashikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës është shterues. Dhënia e dorëheqjes dhe, për rrjedhojë, ndërprerja e procesit të rivlerësimit shoqërohet pashmangshmërisht me ndalimin ligjor për t'u emëruar në pozicione specifike për 15 vjet. Kjo dispozitë zbatohet për të gjitha kategoritë e funksionarëve të sistemit të drejtësisë që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese kanë fituar statusin *subjekt rivlerësimi,* pa bërë dallime ndërmjet tyre, nëse i përkasin kategorisë së subjekteve sipas nenit 179/b, pika 3 apo 4 e Kushtetutës. Në raport me procesin e rivlerësimit, të gjitha këto subjekte konsiderohen të barabarta.

[20] *Shih paragrafin 97 të vendimit nr. 1/2018 -* http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/A.-Llalla-1-1-1.pdf

22. Në përmbledhje të ecurisë kronologjike të ngjarjeve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit zgjodhi të ndërpresë vijimin e procesit mësimor pranë Shkollës së Magjistraturës, pas 1 viti që kishte zgjedhur ta vazhdonte atë dhe të fitonte statusin e magjistratit, në profilin gjyqtar. Njëkohësisht, subjekti i rivlerësimit zgjodhi të mos e vijojë më tej procesin e rivlerësimit, 16 muaj pasi i ishte nënshtruar hetimit administrativ, në një fazë që përkon me fazën që i paraprin shqyrtimit përfundimtar dhe marrjes së vendimit nga ana e Komisionit. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga vijimi i formimit profesional në Shkollën e Magjistraturës, vendimi i Komisionit për të ndërprerë procesin dhe zbatimin e ndalimit nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është i bazuar. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se ndalimi i ushtrimit të funksioneve në sistemin e drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare është parashikuar nga kushtetutëbërësi si pasoja juridike që i atribuohet moskalimit me sukses të procesit të rivlerësimit ose ndërprerjes së procesit. Kjo vendimmarrje qëndron edhe në konsideratë të qëndrimit të shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78/2017[21], sipas të cilit:

> *43. […] Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës […].*

23. Trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë jurisprudencën e konsoliduar tashmë, sipas së cilës paraqitja e aktit të dorëheqjes i jep fund procedurës administrative të rivlerësimit, duke mos lejuar kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme. Konkretisht, Kolegji në vendimmarrjet e mëparshme të tij është shprehur se:

> *[…] 59. Kolegji i Apelimit vlerëson me përparësi zbatimin e institutit të dorëheqjes sipas ligjit të rivlerësimit në krahasim me institutin e dorëheqjes sipas ligjit të statusit, ndërkohë që akti i dorëheqjes, i paraqitur rregullisht, përbën shkak për ndërprerjen/përfundimin e procedurës në mënyrë që dispozita kushtetuese të zbatohet e plotë dhe në përputhje me doktrinën kushtetuese. […]*
> *63. […] Dorëheqja, në vetvete e trajtuar posaçërisht nga Kushtetuta, nuk është shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sikurse nuk përbën shkak për konfirmimin në detyrë dhe, si e tillë, Kushtetuta e ka shoqëruar pandashmërisht edhe me përcaktim negativ të drejtash, siç është ndalimi i ushtrimit të profesionit. Pika 2 e nenit G të Kushtetutës sanksionon: "2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. […]*
> *79. Në kuptimin material, ushtrimi i dorëheqjes nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit përbën shkak ligjor për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, por me kufizimin për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. E thënë ndryshe, ushtrimi*

[21] *Shih: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.*

i dorëheqjes nga detyra shoqërohet edhe me kufizime të drejtash, sipas nenit 6 të "Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut". […][22]

[…] 24. Së pari, trupi gjykues vëren që ndalimi i shprehur në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk përbën kompetencë për vendimmarrje, por është pasojë që ligji krijon për dorëheqjet nga subjekte që zgjedhin të ushtrojnë këtë mjet procedural që garanton ndërprerjen e rivlerësimit, i cili në mungesë të dorëheqjes do t'i nënshtrohej ex officio procesit të rivlerësimit. Komisioni, në këtë aspekt nuk ushtron asnjë aktivitet diskrecional, por ka për detyrë të pasqyrojë pasojën që parashikon pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. […][23]

21.4. […] Për më tepër, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit para trupit gjykues, duke pranuar nga njëra anë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, sipas paragrafit 1 të nenit G dhe duke kërkuar nga ana tjetër, mospërcaktimin në pjesën arsyetuese të vendimit të ndalimit të parashikuar në paragrafin 2 të të njëjtit nen të Kushtetutës, përveçse vjen ndesh me parashikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, vë në dyshim vullnetin real për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit. […][24]

19. Në shqyrtimin e këtij shkaku të ankimit, trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit [...], sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi ex officio në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 58, pika 1, nënparagrafët "a", "b", "c" të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, realizohet përfundimisht nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. […][25]

24. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, për *ometim ligjor* sa i përket rregullimit të situatës në të cilën ajo gjendet, është i pabazuar në ligj. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 parashikojnë në mënyrë të shprehur dhe shteruese subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe ecurinë e procesit, pavarësisht dinamikës së ndodhive që kanë impakt mbi pozicionin nëpërmjet të cilit individët kanë fituar statusin e *subjektit të rivlerësimit*. Dorëheqja e subjektit të rivlerësimit nga vazhdimi i programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës, përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit, në një stad shumë afër fundit të tij, dhe veprimet e ndërmarra prej saj gjatë procesit të rivlerësimit – vënia në dijeni e Komisionit për aktin e dorëheqjes duke e përfshirë në dokumentin që i drejtohej

---

[22] *Shih vendimin nr. 1/2018 (JR), datë 11.06.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Adriatik Llalla - http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/A.-Llalla-1-1-1.pdf*

[23] *Shih vendimin nr. 5/2018 (JR), datë 10.09.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Fana - http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendimi-dhe-Mendimi-paralel.pdf*

[24] *Shih vendimin nr. 17/2019 (JR), datë 25.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo) - http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-V-Bala-i-ANONIMIZUAR.pdf*

[25] *Shih vendimin nr. 18/2020 (JR), datë 29.07.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Genci Sinjari - http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendimi_Genci-Sinjari_anonimizuar_per_web.pdf*

drejtorit dhe këshillit drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe fakti që subjekti kërkon përfundimin e procesit pa vendim përfundimtar – dëshmojnë vullnetin e saj për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në rrethanat konkrete zbatohet parashikimi i nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

25. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka kompetencë të shqyrtojë vlefshmërinë e urdhrit të kryetarit të Gjykatës së Lartë, të datës 25.09.2018. Komisioni është një institucion që nuk mund të konsiderohet gjykatë pasi nuk plotëson *karakteristikat* e detyrueshme të kërkuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, argumenton se urdhri i kryetarit të Gjykatës së Lartë [i datës 25.09.2018] vazhdon të jetë në fuqi, i ka sjellë të gjitha pasojat dhe ishte i domosdoshëm për regjistrimin e saj në Shkollën e Magjistraturës. Marrëdhënia e saj e punës në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8588/2000 për Gjykatën e Lartë, nuk përfundoi me përfundimin e mandatit të gjyqtares me të cilën punonte. Subjekti i rivlerësimit vlerëson rrethanat e shkëputjes së marrëdhënieve të saj me detyrën si *identike* me ato të subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh.. Sipas subjektit, situata faktike e saj nuk është pasojë e veprimeve të ndërmarra, por është pasojë e boshllëkut ligjor që nuk rregullon tranzicionin nga ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë në studente pranë Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë që kishte nisur procesi i rivlerësimit. Humbja e të drejtës për t'u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare KLGj-së ose e KLP-së, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme për një periudhë 15 vjeçare, është kufizim i rëndë i së drejtës për punë, të parashikuar në nenin 49 të Kushtetutës. Komisioni nuk gëzon tagrat që kërkon Kushtetuta dhe KEDNj-ja për ta penalizuar subjektin me këtë masë ndaluese. Komisioni nuk plotëson kushtin për të gjykuar me palë kundërshtare subjektet e rivlerësimit – parimin e kontradiktorialitetit – pasi relatori i çështjes kryen rolin e palës kundërshtare ndaj subjekteve të rivlerësimit, çka cenon procesin e rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

26. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, së pari, është fakt i pakontestueshëm se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, e gëzonte këtë cilësi në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese që parashikuan zhvillimin e procesit të rivlerësimit (shih edhe paragrafin 17 më sipër), shkak për të cilin iu nënshtrua provimit dhe programit të përshpejtuar në Shkollën e Magjistraturës, me objektiv të fitonte statusin e magjistrates. Së dyti, pavarësisht nga mënyra e zgjedhur nga kryetari i Gjykatës së Lartë për të adresuar kërkesën e subjektit për *disponim* mbi marrëdhënien e punësimit të subjektit në Gjykatën e Lartë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ndërprerja e marrëdhënieve të punësimit në atë institucion, nuk është relevante në dritën e faktit të pakontestueshëm që zhvillimet e mëtejshme të karrierës profesionale të subjektit – me fjalë të tjera, tranzicioni i subjektit të rivlerësimit nga këshilltare në Gjykatën e Lartë në studente e ciklit të shkurtuar në Shkollën e Magjistraturës, me objektiv titullin e magjistratit – kanë qenë pasojë pikërisht e faktit që ajo përfshihej në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës. Mundësia për të fituar statusin e magjistrates brenda dy vjetësh [përkundër tre vjetësh që është programi akademik tipik], në përfundim të trajnimit të suksesshëm, iu njoh subjektit të rivlerësimit pikërisht për shkak të të qenit këshilltare ligjore [jomagjistrate], sipas këtyre dispozitave. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mban

në konsideratë, ndër të tjera, edhe parashikimin ligjor në nenin 165, pika 9[26] e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit për ndihmësit ligjorë, ligjvënësi i ka përcaktuar si kusht parësor [*conditio sine qua non*] për vazhdimin e karrierës si magjistrat apo jo, kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit. Ndryshimi mes dy drejtimeve profesionale kushtëzohet vetëm nga zgjedhja për të ndjekur karrierën e magjistratit, e cila për këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë [dhe në Gjykatën Kushtetuese] është një ndër dy opsionet, duke qenë tjetri qëndrimi në detyrën përkatëse.

27. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se vlerësimi që Komisioni i ka bërë urdhrit të kryetarit të Gjykatës së Lartë lidhur me marrëdhënien e punësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, si ndihmëse ligjore, është paralel dhe, për pasojë, pa asnjë peshë mbi faktin që subjekti i rivlerësimit e kishte fituar këtë cilësi në mënyrë të shprehur në parashikimin e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës. Duke abstraguar nga çfarë ka konkluduar Komisioni për subjektin e rivlerësimit, znj. M. Xh., në kushtet kur nuk gjendemi përpara një boshllëku ligjor, znj. Kana, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit *ex officio*, pashmangshmërisht duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit. Ndërprerja e procesit për shkaqe që lidhen me subjektin, sikurse heqja dorë nga procesi i trajnimit, pashmangshmërisht bën që ndaj saj të zbatohet parashikimi i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë kontekst, trupi gjykues vëren se edhe argumenti i subjektit të rivlerësimit në faqen 9 të ankimit, i cili mbështetet në qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në jurisprudencën e GjEDNj-së në vendimin *Delcourt kundër Belgjikës*, mbështet pikërisht përputhshmërinë me Kushtetutën të *ndalimit me ligj* të një të drejte punësimi, përkundër ndonjë interpretimi të zgjeruar të kontekstit të ligjit nga akte nënligjore. Me fjalë të tjera, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese së cilës subjekti i është referuar, pasqyruar në vendimin nr. 20/2006[27], mbështet vendimin e marrë nga Komisioni, në kushtet kur ndalimi prej 15 vjetësh i përcaktuar për subjektet e rivlerësimit që vendosin të ndërpresin procesin e rivlerësimit, është i përcaktuar me nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe jo mbi akte nënligjore apo mbi interpretime të zgjeruara të rrethanave faktike që bien ndesh me alternativat e qarta që përcaktojnë normat që rregullojnë konceptin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, qoftë edhe duke shtuar alternativa apo mangësi të cilat nuk gjenden në Kushtetutë e ligj. Në këtë kuadër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se ligjbërësi ka parashikuar dy drejtime për subjektet e rivlerësimit, ndër të cilët ishte edhe znj. Kana: kalim me sukses i procesit të rivlerësimit dhe konfirmim në detyrë ose shkarkim nga detyra dhe ndalim kushtetues prej 15 vjetësh për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë. Për këshilltarët ligjorë jomagjistratë, alternativa e parë – kalimi me sukses i procesit mund të shoqërohet edhe me fitim të statusit të magjistratit pas programit të përshpejtuar, nëse zgjedhin ta ndjekin atë alternativë profesionale. Për sa më sipër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar në ligj dhe në jurisprudencë.

28. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, për mënyrën e funksionimit të Komisionit, që sipas saj bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, trupi

---

[26] *"[9]. Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit në detyrë kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjekin fushën e karrierës së magjistratit, kanë të drejtë për t'u caktuar në një pozicion si nëpunës civil në sistemin e prokurorisë ose nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tyre aktual dhe për të cilin përmbushin kriteret. […] Ky rregull nuk zbatohet për këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve ligjore."*

[27] *Paragrafi nr. 2, faqja e pestë: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php*

gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se, së pari, mbështetur në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe në nenin Ç, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, kryerja e procesit të rivlerësimit apo ndërprerja e tij është kryekëput kompetencë e Komisionit dhe Kolegjit, për rrjedhojë edhe përcaktimi i pasojave, sikurse në këtë rast, aplikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është kompetencë kushtetuese dhe ligjore e këtyre institucioneve. Së dyti, trupi gjykues i Kolegjit thekson se ligjshmëria e veprimtarisë së Komisionit në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, është analizuar dhe konfirmuar tashmë nga Gjykata Kushtetuese. Konkretisht, në vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017, mbështetur në Opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, Gjykata Kushtetuese ka gjetur se dispozitat ligjore mbi të cilat mbështetet krijimi i institucioneve të rivlerësimit janë në përputhje me Kushtetutën dhe ofrojnë garanci të plota të elementeve të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

> *[…] Për rrjedhojë, për shkak të garancive që ofrojnë këto organe, vlerësohet se subjekteve të rivlerësimit u garantohet e drejta e ankimit në një shkallë më të lartë gjykimi, sipas nenit 43 të Kushtetutës, e cila ka të drejtë të gjykojë në themel çështjen dhe të vendosë përfundimisht në lidhje me të. […]*[28]

> *[41]. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se ofrohen të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së (shih paragrafët 66 dhe 67 të vendimit). Për më tepër, Gjykata theksoi se, në përfundim të procesit të rivlerësimit, KPK-ja jep një vendim të arsyetuar në lidhje me provat dhe arsyet ku është mbështetur, si dhe për përfundimet e nxjerra prej tij (shih paragrafin 55 të vendimit). […]*
> *43. Edhe për sa i takon nenit 56, pika 1 e këtij ligji, kjo dispozitë është vlerësuar si kushtetuese për sa kohë që nuk i mohon subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u dorëhequr, e drejtë që i garantohet atij nga neni G i Aneksit të Kushtetutës. Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që të dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. […]*[29]

29. Më tej, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga ana e Komisionit rezulton të jenë respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit për të ushtruar të drejtat bazuar në parimin e kontradiktorialitetit, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, përpara marrjes së vendimit. Mënyra e funksionimit të Komisionit nuk mund të interpretohet se bie ndesh me parimin e paanshmërisë dhe të kontradiktorialitetit, në kuptim të nenit 42 të

[28] *Shih paragrafin 67, vendimi nr. 2/2017.*
[29] *Shih vendimin nr. 78/2017 http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.*

Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, për sa kohë Komisioni ka zbatuar me rigorozitet procedurën ligjore të normuar shprehimisht në kuadrin ligjor mbi bazën e të cilit funksionon dhe ushtron kompetencat [ligji nr. 84/2016]. Për më tepër, subjektet e rivlerësimit gëzojnë të drejtën të kontestojnë vendimin e Komisionit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, në kuptim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, e drejta për një proces kontradiktor nënkupton parimin e informimit të palëve dhe njohje me çdo dokument ose qëndrim të gjykatës[30]. Nga ana tjetër, paanshmëria përcaktohet kryesisht nga mungesa e paragjykimit ose e anshmërisë dhe duhet të vlerësohet sipas një qasjeje subjektive – duke mbajtur parasysh bindjen personale dhe qëndrimin e gjyqtarit – dhe një qasjeje objektive – duke mbajtur parasysh nëse gjykata ofronte, veçanërisht përmes përbërjes së saj, garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të justifikuar për sa i përket paanshmërisë së saj[31]. Për arsyet e shtjelluara më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, mbështetur në jurisprudencën e GjEDNj-së në çështjen e *Regner kundër Republikës Çeke*, nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi rrethanat faktike dhe ligjore të *Regner* nuk kanë asnjë ngjashmëri me shkaqet e ankimit që ngre subjekti i rivlerësimit. Ndër të tjera, në atë çështje [Regner] kërkuesi ankohej se nuk ishte njohur me një pjesë *të klasifikuar* të fashikullit dhe, për pasojë, e kishte pasur të pamundur të ndërtonte mbrojtjen. Në rastin konkret, hetimi administrativ i subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana, është zhvilluar plotësisht për dy drejtime: së pari, për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit (paragrafi 13 më sipër), dhe së dyti, për dorëheqjen e saj nga vijimi i procesit akademik/praktik pranë Shkollës së Magjistraturës (paragrafët 14 e 15 më sipër). Ky proces ka zgjatur për më shumë së 18 muaj. Përgjatë kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit ka qenë në gjendje dhe ka pasur mundësinë të njihej me dokumentet në fashikull, të jepte shpjegime, të njihej me provat dhe me rezultatet e hetimit duke qenë në proces komunikimi aktiv me Komisionin (shih edhe paragrafët 3, 5 e 13 më sipër). Së fundmi, subjekti nuk rezulton të ketë ngritur në hetimin administrativ apo në ankim pretendime sipas të cilave e ka pasur të pamundur të njihet me fashikullin apo me provat. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

30. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ndërprerja e procesit të rivlerësimit dhe aplikimi i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës nga ana e Komisionit, nuk rezulton të jetë tejkalim i kompetencave të tij ligjore. Përkundrazi, në zbatimin e ndalimit të përcaktuar shprehimisht në Aneksin e Kushtetutës [neni G, pika 2], Komisioni ka vepruar në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore dhe orientimit të dhënë nga Kolegji në çështje të tjera[32]. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

31. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ndalimi për 15 vite cenon të drejtën kushtetuese për punë të parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe të drejtën për një jetë të qetë private, në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të parashikuar nga neni 17, pika 1 e Kushtetutës. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni dështoi në respektimin e parimit të proporcionalitetit, pasi ka vendosur një masë penalizuese të njëtrajtshme për cilindo subjekt kur ndërpritet procesi i rivlerësimit, pa marrë parasysh

[30] Ruiz-Mateos kundër Spanjës, § 63; McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 80; Vermeulen kundër Belgjikës, § 33; Lobo Machado kundër Portugalisë, § 31; Kress kundër Francës [GC], § 74.
[31] Wettstein kundër Zvicrës, § 43; Micallef kundër Maltës [GC], § 93.
[32] Shih, ndër të tjera, poshtëshënimet nr. 22 dhe 23 që lidhen me vendimet e Kolegjit [JR] nr. 1/2018 dhe 5/2018 që u përkasin subjekteve të rivlerësimit Adriatik Llalla dhe Mirela Fana.

specifikat rast pas rasti. Nën dritën e nenit 17, pika 2 e Kushtetutës, për të mos krijuar përplasje me normat kushtetuese dhe me ato të KEDNj-së, Komisioni duhet të vlerësonte specifikën e rastit të subjektit të rivlerësimit dhe të mos arrinte në konkluzione të pabazuara dhe tepër të rënda. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit i ka cenuar të drejtën për jetë private, të mbrojtur nga neni 8 i KEDNj-së dhe i ka dëmtuar reputacionin si një njeri me integritet të lartë moral dhe profesional, duke u mbështetur në jurisprudencën e GjEDNj-së dhe duke iu referuar shprehjeve në disa artikuj në gazeta dhe portale të ndryshme *on-line* dhe në një konferencë për shtyp të një përfaqësuesi të Partisë Demokratike. Sipas subjektit të rivlerësimit, GjEDNj-ja ka pohuar vazhdimisht se çdo ndërhyrje nga autoriteti publik në të drejtën e një individi për të respektuar jetën private duhet të jetë në përputhje me ligjin. Vendimi i Komisionit i ka cenuar të drejtën për punë dhe jetën private, pa asnjë bazë ligjore, pasi largimi nga detyra nuk përbënte dorëheqje sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, por sepse e detyronte neni 165 i ligjit nr. 96/2016. Sipas subjektit, formulimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës bie ndesh me parimet e shtetit të së drejtës pasi parashikon një dënim fiks, shumë herë më të rëndë se dënimi penal në raste të ngjashme dhe në mënyrë joproporcionale vendos trajtim të barabartë për subjekte krejtësisht të pabarabarta. Parashikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës nuk respekton kushtin "i nevojshëm në një shoqëri demokratike", të kërkuar nga neni 8 i KEDNj-së, referuar edhe trajtimit të saj nga GjEDNj-ja. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Kana, shprehet se ndërhyrja në jetën private nuk është në proporcion me qëllimin që synon legjislacioni i rivlerësimit, pasi subjekti nuk ka qenë asnjëherë gjyqtare apo prokurore dhe, për pasojë, nuk mund t'i atribuohet i njëjti kufizim me ta.

32. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit, nën dritën e parashikimeve të nenit F, pika 3[33] e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson të theksojë se kushtetutshmëria e parimeve mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit, nuk është objekt diskutimi. Së dyti, për sa i përket argumentit për cenim të parimit të proporcionalitetit dhe të ndërhyrjes në jetën private, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimet nr. 2/2017 (paragrafët nr. 63, 64, 68) dhe nr. 78/2017 (paragrafi nr. 42) se:

> *[63]. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kufizime të të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen nëse përmbushen disa kushte: të vendosen me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve; duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar ato (parimi i proporcionalitetit/përpjesëtueshmërisë); të mos cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave; dhe në asnjë rast të mos tejkalojnë kufizimet e parashikuara nga KEDNj-ja. Pra, kjo dispozitë kushtetuese kërkon vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes ligjore të shtetit, në varësi të natyrës së të drejtës, të karakterit të interesit publik që duhet të mbrohet, të rrethanave konkrete që e diktojnë një ndërhyrje në minimum dhe sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut. GjEDNj-ja është shprehur: "Sa herë që një shtet mundohet të mbështetet në parimin e "demokracisë së aftë të mbrojë vetveten" në mënyrë që të justifikojë ndërhyrjen në të drejtat e njeriut, ai duhet të vlerësojë me shumë kujdes qëllimin dhe pasojat e masave që ndërmerr, për të siguruar arritjen*

[33] *Neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: "[…] Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe, si i tillë, bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj […]".*

e balancës së lartpërmendur" (shih vendimin nr. 9, datë 23.03.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

64. Gjykata vëren se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë. Gjykata rithekson se është detyrë e organeve të reja kushtetuese të rivlerësimit që gjatë mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së organeve ligjzbatuese të kërkojnë respektimin e standardeve evropiane dhe jurisprudencën e kësaj gjykate si më lart.
[…]

68. Në lidhje me të drejtën për ankim kushtetues individual, në vlerësimin e Komisionit të Venecias, Kushtetuta ka heshtur në lidhje me faktin nëse një subjekt mund të paraqesë një ankim individual para Gjykatës Kushtetuese dhe se në mungesë të një ndalimi nuk ka arsye për të përjashtuar një mundësi të tillë (paragrafi 44 i opinionit CDL-AD (2016)036). Në vlerësimin e gjykatës, Kushtetuta nuk ka heshtur në lidhje me këtë drejtë, ashtu si edhe për disa të drejta të tjera kushtetuese. Gjykata vëren se, sipas nenit A të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim kryerjen e këtij procesi, kufizohet edhe nënparagrafi "f" i nenit 131 të Kushtetutës, çka nënkupton se ky kufizim lidhet specifikisht me të drejtën e subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kurse sipas nenit F, pika 8, po të Aneksit, subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në GjEDNj. Vlerësimi nëse ky kufizim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi, për sa kohë që ai jo vetëm është vendosur në rang kushtetues, por edhe sepse gjykata nuk ka juridiksion për vlerësimin në themel të këtyre dispozitave, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutë me anë të një ligji rishikues. Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KA-së si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën.

42. Edhe në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private dhe familjare, gjykata vlerësoi se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë (shih paragrafin 64 të vendimit). […]

33. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse e ka trajtuar edhe më sipër, thekson se parashikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës është i qartë në frymën dhe gjuhën e tij: dhënia e dorëheqjes dhe, për rrjedhojë, ndërprerja e procesit të rivlerësimit shoqërohen me ndalimin prej 15 vitesh për të

kryer detyra të caktuara në sistemin e drejtësisë[34]. Ndalimi i përcaktuar në këtë dispozitë zbatohet për të gjitha kategoritë e funksionarëve të sistemit të drejtësisë që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, kanë fituar statusin e subjektit të rivlerësimit, pa dallime ndërmjet tyre dhe duke i konsideruar të barabartë në raport me procesin e rivlerësimit. Kjo qasje bëhet edhe më e qartë nëse lexohet në harmoni me qëllimin e procesit të rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës – *garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.* Me fjalë të tjera, kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e procesit të rivlerësimit. Në të kundërt, ligjvënësi ka vendosur në nivel kushtetues ndalimin për rikthim në sistemin e drejtësisë për një periudhë 15 vjeçare.

34. Përpos referimit në analizën mbi proporcionalitetin e masës, kryer nga Gjykata Kushtetuese e riprodhuar më sipër [shih paragrafin 32], trupi gjykues i Kolegjit vëren se në dritën e qëllimit për të cilin është ngritur sistemi i rivlerësimit, ndalimi i ushtrimit të detyrave në sistemin e drejtësisë për 15 vjet, nuk është disproporcional, për sa kohë shteti legjitimohet të sanksionojë ndalime të caktuara në fusha të caktuara të funksioneve publike. Pretendimi i subjektit se ndalimi i zbatuar për të është disproporcional, bie ndesh edhe me kriteret e përcaktuara nga GjEDNj-ja në lidhje me ndalimin me ligj për individë të caktuar, për të kryer detyra të caktuara në sektorin publik. Sipas GjEDNj-së, në *Niadin kundër Rumanisë*:

> *[…] Funksionarët publikë, sidomos ata që si kërkuesi kërkojnë të shërbejnë në pozicione si ai që kërkuesi ka dashur të kthehet, ushtrojnë një pjesë të sovranitetit të shtetit. Ndalimi i kërkuesit, për pasojë, nuk është disproporcional kundrejt objektivit legjitim të shtetit për të siguruar besnikërinë e atyre që mbajnë përgjegjësitë që shoqërohen me interesin e përgjithshëm. 55. Gjykata vëren se shteti nuk ka vendosur ndalime mbi punësimin e ardhshëm të kërkuesit në sektorin privat apo edhe në kompani që paraqesin njëfarë interesi për shtetin në çështje ekonomike […]. Po ashtu, kërkuesit nuk i ndalohet punësimi në një fushë tjetër të sektorit publik, që nuk passjell/përfshin ushtrimin e funksioneve publike[35][…].*

35. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për dëmtim reputacioni, trupi gjykues i Kolegjit thekson se mënyra se si media apo përfaqësues të tjerë të publikut, përfshirë edhe segmente të politikës, interpretojnë vendimet që u përkasin subjekteve të rivlerësimit, është pjesë e së drejtës së fjalës – e drejtë themelore në një demokraci, e materializuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në KEDNj[36]. Në kushtet kur procesi është publik dhe transparent, çdo veprim apo vendim i dhënë mund të bëhet objekt debati dhe i nënshtrohet potencialisht analizës së publikut. Artikujt e sjellë prej subjektit, në mbështetje të pretendimit se procesi i rivlerësimit për të ka përbërë ndërhyrje në jetën private, rezultojnë të jenë pasojë e *statusit publik* të bashkëshortit të subjektit, pasojë për të cilën Konventa ka tashmë doktrinë të mirëpërcaktuar[37] në analizë të garancive të nenit 10 [e drejta e shprehjes] dhe nenit 8 [e drejta për jetë private]. Në këto kushte, në balancë të këtyre të drejtave, GjEDNj-ja ka konstatuar se ndryshe nga individët privatë, politikanët apo funksionarët publikë (sipas doktrinës së statusit publik) do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe kritikave nga mediat apo publiku i gjerë[38], përfshirë edhe për sa i përket pasurisë së deklaruar prej tyre. Në vijim të këtyre rrethanave, për shkak se analiza e pasurisë objekt hetimi për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Kana – për shkak të regjimit të pasurisë martesore, përfshin edhe bashkëshortin e saj – është e natyrshme dhe e

---

[34] Shih edhe poshtëshënimin nr. 3.

[35] Paragrafët 54-55, Naidin kundër Rumanisë, në lidhje me ndalimin kategorik të individëve që të kryejnë detyra të caktuara në institucionet të caktuara publike.

[36] Neni 22 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNj-së.

[37] Shih Tammer kundër Estonisë, Lingens kundër Austrisë, ndër të tjera.

[38] Shih Lingens kundër Austrisë apo Dabrowski kundër Polonisë.

pritshme që, për shkak të zgjedhjeve të bëra prej bashkëshortit për të kryer një funksion me rëndësi, procesi i kontrollit të pasurisë së tij [dhe të subjektit të rivlerësimit] t'i nënshtrohet një interesi publik më të spikatur. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

36. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se argumentet e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit është i paligjshëm dhe i paarsyetuar, e se vjen në kundërshtim me parimet e sanksionuara në Kushtetutë dhe në KEDNj, nuk qëndrojnë. Sikurse rezultoi edhe nga shqyrtimi i ankimit në Kolegj, vendimmarrja është mbështetur në dispozitat e Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të drejtat e subjektit të rivlerësimit janë respektuar gjatë zhvillimit të procesit dhe vendimi është në përputhje me kërkesat e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016.

37. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në kuadrin ligjor dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për shkaqe që lidhen me subjektin e rivlerësimit, ka konstatuar se deklarohet humbja e së drejtës për t'u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i bazuar në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 233, datë 03.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 21.12.2020.

ANËTARE	**ANËTAR**	**ANËTARE**
Albana Shtylla	**Ardian HAJDARI**	**Natasha MULAJ**
nënshkrimi	*nënshkrimi*	*nënshkrimi*

RELATORE	**KRYESUESE**
Rezarta SCHUETZ	**Ina RAMA**
nënshkrimi	*nënshkrimi*